



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **25.01.2022**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Defrim Kafexhiu**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përhëndes, i nderuar Kryetar i Komunës z. **Smajl Latifi**, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave, qytetarë të Komunës së Rahovecit dhe gjithë ju të pranishëm! Kjo është seanca e parë për këtë vit kalendarik dhe uroj që të na shkojë mbarë dhe të japim më të mirën nga vetja që qytetarët të jenë të përfaqësuar në institucionet komunale. Unë, si kryesues i Kuvendit në konsultim me kryetarin e Komunës i kemi përgatitur këto pika për seancën e sotme.
Për këtë mbledhje sot propozojmë këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbaleve nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e komiteteve obligative;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Komunës së Rahovecit për vitin 2021;
7. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Para se me fillua në pikën e parë të rendit të ditës, si kryesues propozoj me betimin e anëtarëve të rinj të kuvendit komunal të cilët ishin në listën e pritjes që gjithsej janë 5 anëtarë të rinj, që ju uroj mirëseardhje dhe që të punojmë bashkarisht për të mirën e qytetarëve. Ata janë Hasan Përboqi, Artan Asllani, Afrim Berisha, Arbër Zenuni dhe Doruntina Sopjani, që janë prezent në sallë dhe kërkoj që të ngritën që ta lexojmë deklaratën e betimit të anëtarit të kuvendit komunal.

Unë....., betohem që do ti kryej me nder, besnikëri, pa anime dhe me ndërgjegje sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i kuvendit të komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurojmë kushte për jetë të qetë për të gjithë.

Fillimisht duhet që votohet rendi i ditës. E qesim në votim rendin e ditës. Konstatohet se unanimisht aprovohet rendi i ditës.

Tani vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara.

Atëherë a ka dikush diçka sa i përket procesverbaleve të datës 3.12.2021 konstituimi i kuvendit, të datës 13.12.2021 dhe të datës 22.12.2021 që janë dy seanca një e rregullt dhe një e jashtëzakonshme. Kështu që pasi që nuk kemi asnjë të lajmëruar sa i përket procesverbaleve, e qesim në votim. Konstatohet se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

RAHOVEC / ORAHOVAC
Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/168 Nr. i faq./Br.str./No pr. 01
Data/Datum/Date 28 / 02 / 2022

2. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e komiteteve obligative.

Në këtë pikë të rendit të ditës, vendimin e keni përpara për shqyrtim, ku te pika 1.2 Komiteti për Komunitete do ti këtë 7 ulëse. Kështu që unë si kryesues i kuvendit propozoj që në bazë të udhëzimit administrativ nuk është përcaktuar numri i anëtarëve të këtij komiteti dhe unë propozoj që numri të jetë 9 anëtar ku çdo parti të jetë e përfaqësuar në këtë komitet dhe po ashtu shumica janë komunitete. Fillimisht kërkon një arsyetim nga Zyra Ligjore.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, e qitet ne propozim për numrin e përfaqësuesve të Komitetit për Komunitete. Unë po mendoj që nuk është mirë të votojmë dhe të ngutemi si proces, pasi ju propozuat që do të ishte mirë me i pas 9 anëtar që të jenë të përfaqësuar të gjitha partitë dhe në të mirë të përbërjes së komitetit. Gjithashtu e potencove se do të ishte mirë me pas mendimin apo opinionin e Zyrës Ligjore që me arsyetue për numrin 7 apo 9 anëtar të Komitetit për Komunitete apo është obligative me qenë 7 kurse me shkua më tutje në votim, pra ky është diktumimi i asaj që ka dal ky vendim në rend të ditës.

Isak Hoti – Përshëndetje për te gjithë. Mendoj se udhëzimi administrativ është shume i qartë ku te neni 5, e keni funksionimin e komiteteve për politike dhe financa dhe neni 7 e keni funksionimin për komunitete. Sipas numrit të ulëseve e kemi përcaktuar edhe propozimin qe e kemi dhënë si zyrë ndërsa për komunitete nuk kemi gjetur me shume se 4 anëtar, që janë serbët, ashkallitë, romet dhe egjiptianet. Nëse ju doni me bo një ndryshim dhe doni me shtue plus një serb atëherë mundësitë janë dhe kjo shkon me votë të kuvendit dhe si të doni mundeni me percaktue 7 apo 9 anëtarë.

Kryesuesi - Atëherë te vendimi për themelimin e komiteteve të përhershme, e qesim ne votim pikën 1.2 që kuvendarët me vendos që a janë për 7 anëtar apo 9 anëtar.

Besa Bytyqi – I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtor te drejtorive. Ne si grup i Aleancës për ardhmërinë e e Kosovës e votojmë propozimin që Komiteti për Komunitete të jetë i përbërë prej 7 anëtarëve.

Bejtullah Deliu – Përshëndetje i nderuar kryesues, kryetar dhe ju kolegë te nderuar. Partia Demokratike e Kosovës propozon që ky komitet të përbëhet nga 7 anëtar.

Kryesuesi – Sa për sqarim se nëse vendosim që Komiteti për Komunitete të ketë 7 anëtar atëherë njëra prej partive të përfaqësuar në kuvend nuk do ta ketë një anëtar të përfaqësuar në këtë komitet.

Kështu që pasi që nuk kemi të lajmëruar për ndonjë propozim, atëherë pikën e dytë te rendit te ditës e qesim ne votim ashtu siç është pra komiteti për Komunitet ti ketë 7 ulëse dhe gjithashtu edhe Komiteti për Politikë dhe Financa ti ketë 7 anëtarë. E qesim ne votim pikën e dytë te rendit te ditës. Konstatoj që unanimisht aprovohet pika e dytë e rendit te ditës për themelimin e e Komiteteve te përhershme. Gjithashtu kërkoj falje që nuk e thash ne fillim se duhet të vendosen edhe grupet e përfaqësuar në kuvend, pra, duhet të vendosen emrat e shefave të grupeve, që shkojmë me radhë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

Shqipe Kryeziu – Përshëndetje kryesues, kryetar, nënkryetar dhe gjithë ju te pranishëm. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës për shefe të grupit e ka emëruar znj. Besmire Bytyqi.

Merisa Sharku Vuçiterna – Përshëndetje për te gjithë. Levizja Vetvendosje për shef të grupit e propozon z. Leonard Morina.

Faton Ramadani – Përshëndetje për te gjithë. Po ashtu edhe Lidhja Demokratike e Kosovës për shef te grupit e propozon z. Burim Krasniqi.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje kryetar, nënkryetar, drejtorë te drejtorive, kolegë asamblistë. Ne Partia Demokratike e Kosovës e propozojmë z. Bejtullah Deliu.

Kryesuesi – Faleminderit te gjithëve për te gjitha propozimet, kështu që kalojmë ne pikën e tretë te rendit te ditës:

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Në mbështetje te nenit 12, paragrafi 2 i nenit 51 dhe 52 te ligjit nr.03L-040 për vetëqeverisje lokale ne mbështetje te nenit 5 te udhëzimit administrativ nga MAPL-ja 05/2020 për procedurën e themelimit përbërjen dhe kompetencat e komiteteve te përhershme dhe komiteteve tjera ne komunë, i nenit 2,10 paragrafi 1 dhe 2.4

i nenit 30,31,32 dhe 40 te statutit te komunës se Rahovecit nr 1005 i datës 29.03.2017,kuvendi i komunës se Rahovecit shqyrton vendimin për themelimin e komitetit për politikë dhe Financa. Me këtë vendim kuvendi i komunës se Rahovecit shqyrton propozimet për anëtarë nga grupet e asamblistëve te komitetit për politikë dhe financa. Kështu që ndarja është ne bazë te përqindjes se votave të ulëseve ne kuvendin komunal, nga AAK-ja janë 3 delegatë, nga VV-ja janë 2 delegatë, nga LDK-ja me 1 delegatë dhe PDK-ja me 1 delegatë. Atëherë vazhdojmë me propozimet per delegatë ne Komitetin për Politikë dhe Financa nga grupet e asamblistëve te përfaqësuar ne kuvend.

Besmire Bytyqi – Grupi i Aleancës për ardhmërinë e Kosovës për anëtar te Komitetit për Politikë dhe Financa e cakton Besmire Bytyqi, Rumir Zhuniqi dhe Bjondina Kleqka.

Leonard Morina – Përshendetje për të gjithë. Lëvizja Vetëvendosje e propozon z. Bejtullah Deliu dhe Defrim Kafexhiu.

Faton Ramadani – Ne si LDK për anëtar te KPF-së e propozojm z. Burim Krasniqi.

Bejtullah Deliu – Ne si PDK për anëtar te KPF-së e propozojmë Melinda Iska.

Kryesuesi – Atëherë në përputhje me legjislacionin ne fuqi me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Rahovecit i emëron anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me këtë përbërje:

Defrim Kafexhiu – Kryesues – LVV

Besmire Bytyqi – AAK

Rumir Zhuniqi – AAK

Bjondina Kleqka – AAK

Burim Krasniqi – LDK

Melinda Iska – PDK

Bejtullah Deliu – PDK

Shqipe Kryeziu – Te anëtarët e për KPF nga lëvizja Vetëvendosje për Defrim Kafexhiu krejt ne rregull mirëpo Bejtullah Deliu ka aderuar në Vetëvendosje, pasi unë që kam aderuar po dihet edhe ku jam e ulur, kjo vërtet duket e e paqartë, kështu që kish pas mundësi një sqarim të shkurtë për këtë para se me hy ne votim sigurisht se ka nevojë per diskutim.

Kryesuesi – Pasi që nuk është e përcaktuar atëherë nuk po besoj që ka ndonjë problem rreth kësaj dhe mundemi me vazhdue tutje pa bërë polemika për këtë çështje.

Besa Bytyqi – Faleminderit kryesues, por ju e keni qit ne votim duke propozuar nga PDK-ja me dy anëtar te KPF-së pasi ne e dimë se dy anëtar te kësaj partie nuk i takojnë dhe ju duhet me qitë ne votim nga lëvizja Vetvendosje emrat Defrim Kafexhiu dhe Bejtullah Deliu.

Sinan Kryeziu – Unë mendoj se ligji na lejon me propozua edhe anëtar tjerë për anëtar të KPF-së.

Kryesuesi – Sa për sqarim, deri sa nuk jemi ndesh me ligjin atëherë nuk po besoj që kemi ndonjë problem rreth kësaj dhe ne duhet me vazhdua tutje dhe këto polemika mundemi me adresua në pikën e fundit të rendit të ditës, në pyetjet dhe përgjigjet ku mundemi me diskutua këtë çështje me gjerësisht. Kështu që këtë listë me emrat e anëtarëve te Komitetit për Politikë dhe Financa e qesim ne votim. Konstatoj se me 5 abstenime asnjë kundër dhe me shumicë të votave aprovohet vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në përbërjen e lartcekur. Tani kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Në bazë të legjislacionit në fuqi, kuvendi i komunës së Rahovecit shqyrton vendimin për themelimin e Komitetit për Komunitete, ku shumica e anëtarëve janë nga përfaqësues të komuniteteve, ku i kemi 3 emra prej 4 emrave nga radhët e komuniteteve si Dusan Stojanoviç nga komunitetit serb, Bajram Morina nga komuniteti ashkali, Ramë Berisha nga komuniteti egjiptian dhe nga komuniteti rom ende nuk e kemi emrin dhe presim prej Zyrës Komonale për Komunitete që të delegojnë një emër për këtë komunitet. Në këtë komunitet është i përfaqësuar nga 3 grupe të assembleistëve nga Kuvendi Komunal, pra një nga Aleanca, një prej Vetëvendosja dhe një prej Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Besmira Bytyqi – Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozon për anëtarë të Komitetit për Komunitete znj. Shqipe Kryeziu.

Leonard Morina –Grupi i Vetëvendosjes e propozon Edona Kryeziun për anëtare për Komitetin për Komunitete edhe sa i përket propozimeve mendoj se lëvizja Vetëvendosje vendos vet kënd me propozua dhe Shqipja ka harrua se nuk është anëtare e Vetëvendosjes për me tregua se kënd e propozojmë ne.

Shqipe Kryeziu – Unë isha shumë e qartë pasi unë kam aderua në Aleancë dhe nuk turpërohem por veç krenohem me aderimin tim dhe e di se ku jam e ulur, unë veç pyeta mos ka ndodhur ndonjë risi te ju pasi që një ju ka largua e mos ju janë afruar dy nga radhët e PDK-së.

Burim Krasniqi – Ne si grup i LDK-së e propozojmë z. Faton Ramadanin.

Hasan Përboqi – Përshëndetje kryesues, kryetar, kolegë asambleistë, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gjithë të pranishëm. Atëherë unë kam një pyetje për këtë rend ditë që na keni dergua si ne dokumentin për Komitetin për Politikë dhe Financa ashtu edhe në Komitetin për Komunitete shkruan, e precizoj në Komitetin për Komunitete AAK-ja e ka 1, po ashtu edhe VV-ja dhe LDK-ja e kanë një anëtar. Kështu që propozimin e VV-së nuk e di se ku me shkruajt te VV-ja apo LDK-ja, pasi anash është e precizuar se VV-ja e ka një anëtar.

Kryesuesi – Unë mendoj se diskutimi duhet me u mbyllë ne momentin kur i kemi emrat për formimin e komitetit për Komunitete dhe këto polemika te panevojshme nuk besoj që i bëjnë dobi kësaj seance.

Besmira Bytyqi – Mendoj se duhet me pas kujdes në fjalorin pasi që polemika të nevojshme ose të panevojshme i caktojme ne këtu që jemi, kështu që ju kisha lutur që me pas kujdes në fjalorin pasi ky është ofendim për neve dhe ne diskutojmë atë që duam ne dhe ju nuk mundeni me na caktua se çka me diskutue ne.

Burim Krasniqi – Eshtë fakt që është delegatë prej LDK-së ne asamblenë komunale por është e propozuar nga VV-ja dhe ju mundeni me shkrua ku ju dëshironi por do të ishte mirë me votua Komitetin për Komunitete, përndryshe është fakt që është e propozuar nga VV-ja dhe mundeni me shkrua te VV-ja pa asnjë problem.

Edona Kryeziu –Përshëndetje për të gjithë. Pasi emri im u bo diskutabil por dua të ju them se unë delegatë e LDK-së dhe secila parti ka të drejtë me propozua cilindo kandidat.

Kryesuesi – Atëherë shqyrtimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete me këta emra: Shqipe Kryeziu, Edona Kryeziu, Faton Ramdani, Dusan Stojanoviç, Bajram Morina, Ramë Berisha dhe një emër që e presim nga Zyra për Komunitete për komunitetin rom. A jeni për aprovimin e këtij komiteti, kështu që e qesim në votim. Konstatoj se me një votë kundër, tre abstenime dhe me shumicë të votave aprovohet vendimi për themelimin e Komitetit për Komunitete. Kalojmë ne pikën e pestë te rendit te ditës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i i vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri ne Bashkësi (KKSB-së)

Kuvendi i Komunës së Rahovecit e shqyrton vendimin për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi me këtë përbërje:

1. Smajl Latifi – Kryetar i Komunës;
2. Fazli Morina – Komandant i stacionit të Policisë;
3. Nysret Abazibra – Bashkësia Islame në Rahovec;
4. Ylvi Shehu – Teqeja e Madhe “Shejh Sylejmanit”;
5. Sabahudin Durguti – Teqeja e “Haxhi Shejh Iliaz Shehut”;
6. Milan Stojanoviç – Kisha ortodokse serbe;
7. Egzon Hamza – Komuniteti Egjiptian,
8. Valon Berisha - Komuniteti Romë;
9. _____ -Komuniteti Ashkali;
10. _____ - Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
11. Biljana Nakalamiç – Komuniteti serb;
12. Abestrim Rexhepi – Përfaqesues i FSK-së;
13. _____ -zyrtar/e për barazi gjinore;
14. Avni Morina – Drejtor i Drejtorisë për Arsim;

15. Ymret Reshiti – Kryetar i Këshillit të Prindërve;
16. Enis Berisha – KLSP;
17. Beqir Hamza – KEVSB;
18. Shani Hoti – KLSP-Spektori C;
19. _____ - Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim;
20. Vjollca Gurguli – SHL-Kosova;
21. Lendrit Qeli – ZKKK;
22. Shaip Shala – media lokale;
23. Fadil Sylka – Komuniteti i Bizneseve;
24. _____ -Komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.

Besmira Bytyqi – Për anëtarët që i kemi nga lista e OJQ-ve si Vjollca Gurguli dhe Lulzim Krasniqi. Kështu që kërkoj sqarim rreth për këtë pasi a duhet me votua vetëm njërin prej këtyre dyve apo si duhet të veprojme.

Kryetari – Përsëritet për kryesuesin, anëtarët e kuvendit, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit. Sigurisht se një përfaqësues nga OJQ-të duhet të jetë edhe pse dëshira jonë është të jenë më shumë por sipas udhëzimit administrativ nuk mund që ta tejkalojmë numrin e nevojshëm edhe për shkak se anëtarët e KKS-së paguhen, por në rastin konkret e jap përparësi SHL-Kosova për shkak se është organizatë me aktive dhe sigurisht se është edhe e gjinisë femërore.

Kryesuesi – Atëherë këtë përbërje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi e hüdhe në votim. Konstatohet se me shumicë të votave aprovohet edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar i Komunës së Rahovecit për vitin 2021.

Afrim Limani – I nderuari kryesues, kryetar, ju asamblistë më lejoni që t'iu përsëritet dhe t'iu uroj punë të mbarë në këtë mandat. Raporti financiar vjetor është i përberë nga tri pjesë: pjesa e të hyrave, pjesa e realizimit të buxhetit dhe pjesa e aktiviteteve që janë krye në kuadër të Zyrës së Prokurimit. Para se me lexua raportin më lejoni t'iu them se për shkak të shpejtësisë të përgatitjes së këtij raporti dhe shfrytëzimit në raport me kohën që i kemi përvjedhur dy gabime të cilat gjatë leximit tim me vonë do të ju sqaroj dhe sigurisht se do të ju tregoj se ku janë ato gabime mirëpo gjithsesi me vonë raportin final të përgatitur do të vjen në emailin tuaj dhe ky raport do të publikohet në webfaqen e komunës. Të hyrat e rregullta në total për këtë vit janë 1,172,638 euro dhe kur e bëjmë një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar atëherë e kemi një ndryshim negativ prej 10,034 euro. Më lejoni të ju them se në mandatin e parë në të njëjtën periudhë të hyrat e rregullta kanë dallime nga të hyrat e përgjithshme sepse në kuadër të hyrave të përgjithshme i kemi edhe gjykatat dhe trafikun që në konsiderojmë apo i trajtojmë si të hyra të jashtëzakonshme. Në faqe 3 i kemi dy tabela të cilat janë të prezantuara realizimi i të hyrave sipas muajve dhe realizimi i të hyrave në bazë të viteve që ju mund ta vëreni një krahasim nga viti 2015 deri në vitin 2021 sipas organizimit të hyrave. Pastaj gjykatat dhe trafikun për këtë periudhë që ju në raport i kemi 222,377 mirëpo pas ndryshimit të këtij raporti në ndërkohë e kemi pranuar edhe raportin për tre muajorin e tretë të këtij viti që në total prej 72,221 kështu gjithsej i kemi 295,098 euro. Gjithashtu njëjtë edhe për gjykatat dhe trafikun që kanë për 3 muajorin e tretë që është 4536 euro që kap shumën 18.666 euro dhe inkasimi është 23,202 euro. Atëherë bashkë me gjykatat dhe trafikun dhe të hyrat e rregullta në total i kemi 1,414,251 dhe nëse e qesim edhe ndryshimin që kemi të gjykatat dhe trafikun atëherë kemi në total realizimi i të hyrave për vitin 2021 është 1,491,446 euro që është një ndryshim pozitiv me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar prej 95,379 euro. Në faqen 6 kemi të prezantuar të hyrat sipas kategorive ekonomike kodeve ekonomike ndërsa në faqe e shtatë janë të prezantuara si kategori e veçantë të hyrat të inkasimit tatimit në prone ku janë të specifikuar të gjitha të hyrat në raport me planifikimin dhe krahasimin e vitit 2021. Pjesa e dytë e këtij raporti është shpenzimi i buxhetit dhe gabimi që është përvjedh siç e thashë dhe në fillim është se në faqe 8 totali i shpenzimit të buxhetit 15,703 euro, shënimet korrespondojnë se shpenzimi i buxhetit është 15,042,986 euro që shprehur në përqindje është 98,67% dhe njëherë njihet edhe si periudha më e mirë e shpenzimit të buxhetit. Ndërsa nga faqja 11 deri në faqen 16

janë te prezantuara kategoria e mallrave dhe shërbimeve pra shpenzimi i buxhetit ne kuadër te kësaj kategorie sipas te gjitha programeve ku në faqe 16 kemi të paraqitura shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve ku ju mund te shihni ne mënyrë te qartë sipas kategorive. Në faqe 19 janë te prezantuara shpenzimet komunal ndërsa pjesa e tretë e shpenzimit te buxhetit janë të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet që janë bërë ne kuadër te zyrës se prokurimit gjithashtu janë te prezantuara ne mënyrë transparente dhe analitike e shpenzimeve si mallra dhe shërbime subvencione komunal dhe investimet kapitale dhe krejt ne fund i kemi te prezantuara publikimet financiare te komunës se Rahovecit e cila u bartë nga viti 2021 ne vitin 2022 te obligimeve financiare që ju e keni ne raport me shumen 2,139,419 që realisht kjo te investimet kapitale është përvjedhur një gabim teknik për shkak te shpejtësisë së raportit dhe shume është rrit për 156,000 euro që ne këtë rast i kemi ndihmua edhe vetit dhe kur e minusojmë këtë vlerë atëherë obligimet financiare për investimet kapitale janë 1,979,000 që realisht kur e minusojmë ne total obligimet financiare janë ne shumen 2,033,000 euro.

Leonard Morina – Ne raportin financiar te vitit 2021 më shume ka vërejtje e dështime se sa realizime. Në tabelën 1.3 ne katër mujorin e fundit shtator- dhjetor të hyrat për vitin 2020 kanë qenë 424,487,45 cent ndërsa për vitin 2021 kanë qenë 382,904,36 cent që i bie me një diferencë prej 41,584 euro, pastaj te krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2021-2020 ne faqe nr.6 te tabela 1.5 te kodit 50012 taksa për ndërrimin e destinimit për shfrytëzimin e tokës, keni planifikuar 2000 euro ndërsa keni realizuar vetëm 21 euro që i bien 98,95 % keni dështuar prej planifikimit ne realizim. Tek kodit 50013 taksa për certifikata te lindjes keni planifikuar 14,500 euro ndërsa janë realizuar 2512 euro, që i bien se keni dështuar 82,68%. Tek kodit 50026 taksa për legalizimin e objekteve keni planifikuar 28,001 euro ndërsa realizimi ka qenë 10,645,63 cent, që i bien se keni dështuar me 61,99%. Pastaj kodit 50045 leje mjedisore komunale keni planifikuar 8000 euro kurse keni realizuar 1922,33 cent që i bie se keni dështuar me 75,97%. Pastaj kodit 50104 gjoba nga inspektoriat keni planifikuar 2000 euro kurse keni realizuar 735 euro që i bie se keni dështuar për 63,25%. Pastaj kodit 50405 shfrytëzimi i pronës publike që keni planifikuar 30,447 euro ndërsa keni realizuar 1920 euro që i bie se keni dështuar 85,78%, pastaj kodit 50409 participimi në bujqësi ku keni planifikuar 80,000 euro ndërsa keni realizuar 20,285 euro që i bie se keni dështuar për 74,64%, pastaj kodit 50409 arsimit jo formal që keni planifikuar 15,000 euro ndërsa keni realizuar zero euro e që i bie se keni dështuar 100%. Pastaj kodit 50507 inspektimi higjienik sanitar ku keni planifikuar 100 euro ndërsa realizimi është zero euro, që do të thotë se keni dështuar 100%. Këto janë disa prej dështimeve ku prej 38 kodeve, 22 prej tyre kanë dështuar me shumë se 50% që në total i bie 57% dështim prej të gjitha këtyre kodeve. Ne faqe 11, tek tabela 3.3 te shpenzimet e telefonisë mobile, Zyra e Kryetarit në vitin 2020 ka shpenzuar 829,25 cent ndërsa ne vitin 2021 ka shpenzuar 31,96 cent, do të doja një sqarim rreth kësaj se si shkon procedura e pagesës. Pastaj në faqe 13 tek kodit 13440 drejtorja e bujqësisë shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillë dhënëse në vitin 2020 ka shpenzuar 3204 euro, kështu që nëse kish pas mundësi një sqarim me te hollësishëm se si janë shpenzuar këto ne drejtorinë e bujqësisë. Pastaj ne faqe 14, te kodit 13133 shpenzime tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit, drejtorja e arsimit ne vitin 2021 ka shpenzuar 32,486 euro edhe këtu kërkoj një sqarim rreth këtyre udhëtimeve që janë bërë brenda vendit. Në faqe 21,raporti i kontratave te nënshkruara ne vitin 2021 ku janë nënshkruar kontrata me vlerë mbi 10 milion euro ndërsa ne vitin 2022 komuna ka obligime prej këtyre kontratave me vlerë prej 2.5 milion euro. Dhe pyetje për kryetarin a keni planifikuar se si do ti mbulonit këto obligime.

Burim Krasniqi – Unë potencoj që raporti financiar kur bohet i vitit paraprak si udhërrëfyes për buxhetin e këtij viti për rishikimin e buxhetit që bëhet në qershor dhe buxhetin e vitit tjetër që vjen që për me mujt me ruajt në kontinuitet dhe me ju përmbajtë kornizave afatmesme buxhetore ndër vite. Raporti financiar është mirë po besoj te pjesa e kryetarit dhe bordit të drejtoreshave, pastaj Komiteti për Politikë dhe Financa do të ishte mirë me heq pasi është larguar sot dhe nuk është formuar KPF-ja në këtë raport edhe pse në raporte tjera kjo ka ndodhur dhe kjo është veçse një shabllon i raporteve dhe nuk është formale. Por, meqenëse komiteti nuk ka qenë funksional atëherë po besoj që nuk e ka vendin si tekst këtu në këtë raport. Pastaj te tabela 1.2 tek te hyrat realizimi i vitit 2020 është 1,182,000 kurse planifikimi për vitin 2021 është 1,061,000 a ka qenë qëllimi që realizimi me tejkalua planifikimin pasi gjithmonë planifikimi duhet te jet mbi realizimin e vitit paraprak,

ngase te hyrat vetanake llogariten me pas rënie nder vite atëherë kjo është e palogjikshëm por po besoj që prej 1,182,000 realizim ne vitin 2020 dhe me pas planifikim për vitin 2021 ne shumen prej 1,061,000, atëherë kjo nënkupton që ne kemi realizue mbi 100% te te hyrave vetanake. Tek tabela 3.1, i nderuari drejtor e keni një gabim aritmetik tek zyra e kuvendit komunal ku 109,000 plus 9000 atëherë bëjnë me shume 32,600 euro ,pastaj diçka që është paska shqetësuese nuk e di si ka qenë ne praktikrat e mëhershme edhe pse është fillimi i mandatit, ku zyra e kryetarit me pas me shume 351,505 euro, paga mëditje dhe subvencione janë 113,000 euro krejt ne rregull por 238,000 euro me pas veç paga dhe mëditje mallra dhe shërbime duket se është një vlerë shume e madhe për zyrën e kryetarit te komunës, kështu që kisha kërkua sqarim rreth kësaj dhe dua te di se kush hin ne zyrën e kryetarit te komunës dhe cila është përbërja që me marr 238,000 prej buxhetit te komunës se Rahovecit. Pra gabimet e keni tek investimet kapitale, pasi në faqe 9 tek rekapitullimi keni thënë 4,961,000 ndërsa ne faqe 8 e keni 5,3000 që dallon për mbi 42,000 euro. Tek kodi 11, kodi 13440 shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshillë dhënëse 2020 janë 6770 euro kurse ne vitin 2021 janë 4360 euro për kuvendin komunal. Unë nuk kam qenë pjesë e kuvendit por kisha kërkuar prej ish asamblistëve se çfarë këshillë dhënie keni pasur ne vlerë prej 4360 euro ne mandatin e kaluar te asamblesë te vitit 2021 por edhe 6000 euro te vitit 2020. Poashtu nuk e di dhe skam informacion se a kemi ngrohje qendrore në ndonjë objekt ne komunën e Rahovecit, pasi e shoh se ka kursim te nafta por e shoh se ka edhe naftë për ngrohje edhe vaj për ngrohje diçka absurde me duket por sido që te jetë nuk kam informacion sa ka objekte komunale që ngrohen me naftë dhe vaj. Gjithashtu te njëjtin shqetësim e kam edhe me Leonardin te çështja e shpenzimeve për udhëtime zyrtare brenda vendit 32,439 euro eshte diçka e paarsyeshme sepse për shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit e di që paguhen mëditje vlere e naftës që shpenzohet ne mjete zyrtar me siguri janë shpenzime tjera që përfshihen ne këtë. Poashtu i nderuari drejtor nuk e di pse po përsëritën kodet disa herë kur 1.3 e keni disa herë të përsëritur te shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, a mundet që te jetë e përmbledhur me një vend apo duhet me u përsërit disa herë psh tek tabela 3.4 faqe 16. Te çështja e kodeve tek investimet kapitale faqe 21 tek obligimet faktikisht 26,273 euro, ndërtimi i sistemit te ujësjellësit ne komunën e Rahovecit, hapja e pusit te ujit te pijes ne fshatin Senoc. Kështu që unë dua te di që se a ka ujë ne Senoc, a u finalizua ai pus dhe a po furnizohen qytetarët me ujë, ku meqenëse është një kontratë prej 32,000 euro ku 26,000 euro janë obligime te investimeve kapitale. Pra drejtor sipas jush obligime kontraktuale per vitin 2021 që janë grumbulluar janë 10,055,827 euro që janë kontrata 1- vjeçare, 2-vjeçare, 3 vjeçare dhe krejt këto janë komplet si obligime, por ajo që është shqetësuese dhe e habitshme ka disa shpenzime ne drekave zyrtare dhe jo zyrtare por me hangër bukë edhe mos me pagua kjo nuk është ne rregull, kështu që këto ti paguani me kohë bizneset, pasi shoh që ka fatura te muajit 9-të ,10-të por edhe te mëhershme që janë dreka zyrtare neper disa biznese që parimisht kjo nuk është ne rregull pasi të paktën këtyre bizneseve duhet te ju qëndroni gati rreth pagesës, pastaj kemi një gabim tjetër ne faqe 29,30,31 që janë te përsëritura numri i faturave komplet dhe tek përmbledhja ne fund ne faqe 32 përmbledhja e obligimeve financiare, ku këto obligime financiare nënkupton komplet kontratat apo nënkupton faturat, pasi nëse është komplet kontratat tek investimet kapitale nuk është 2 milion por është 10 milion, kështu që unë po besoj që ky raport financiar duhet me u kompletue dhe me qenë ne fund 10,058,000 obligime kontraktuale që dalin komplet deri ne vitin 2021 që janë bartur për ne vitin 2022 qoftë si borxhe financiare me fatura të pranuar apo si obligime kontraktuale sepse një komizë afatmesme buxhetore duhet me u miratua në shtator atëherë duhet me qenë ne orientimin e buxhetit ose ne kontratat e lidhura që i kemi. Përveç kësaj unë po konsideroj që komuna duhet me raportua ne mënyrë reale te gjitha obligimet që janë nder vite. Unë e kam një tabelë këtu dhe nëse nuk qëndron atëherë do te ishte mirë me than se nuk qëndron ashtu por e di që ka borxhe që nga viti 2012 e këndeje dhe unë këtë informacion e kam marr ne muajin qershor dhe që kanë kapur vlerën totale prej 12 milion dhe duke ja shtuar edhe kontratat e lidhura që kanë ndodhur ne vitin 2021 që është afër 10 milion që gjithsej shkojë deri ne 22 milion obligime kontraktuale. Pra, ne vitin 2012 i keni 3499 euro, pastaj ne vitin 2013 i keni 58,700 euro, ne vitin 2014 i keni 51,700, pastaj ne vitin 2015 i keni 61,000, pastaj ne vitin 2016 i keni 334,000, pastaj ne vitin 2017 i keni 180,000, ne vitin 2018 i keni 977,000, ne vitin 2019 i keni 892,0000 euro, ne vitin 2020 i keni 3,728,000 pra janë obligime kontraktuale te

bartura që besoj që do të ishte mirë me rrumbullaksue ne raportin financiar edhe pse është një vjeçar por me ditë gjendjen e sakt të obligimeve që komuna ka ne raport me kontraktoret edhe faturat e pranuar që mund të qojnë ne përmbarrim si fature por edhe si obligime kontaktuale të cilat paralelisht nuk mundën me que ne procedurë përmbarrimore edhe ligjërisht por ne anën tjetër të marrin peng këto obligime kontraktuale. Kështu që unë po konsideroj që buxheti kur të miratohet edhe ne rishikim të buxhetit që vjen ne qershor por edhe buxheti për vitin e ardhshëm me qenë ky raport financiar që të jemi të qartë si asamble komunale se ku po dërgojmë komunën ne kuptimin e gjendjes financiare aktuale dhe gjithashtu kam edhe një pyetje tjetër pasi nuk janë të përfshira procedurat kontestimore që i ka komuna nëpër gjykata e një nder to është edhe çështja e shujtave ore zëvendësimeve të arsimtareve që veçse kanë filluar me pas vendime prej gjykatave dhe po besoj që përfaqësuesi i avokatit të komunës e ka informacionet dhe komuna e din afërsisht se ku mund të sillen obligimi që mund të rrjedh nga vendimet e gjykatës që me pas një përfshirje të asaj që me ditë saktësisht se ku po del komuna financiarisht ne qershor dhe ku me rishikimin e votimit të buxhetit për vitin 2023.

Besa Bytyqi –Faleminderit kryesues, e falënderoj drejtorin Afrim Limanin që na ka sjellur një raport shumë të detajuar me të gjithë gjërat që duhet të i përmbaj një raport dhe gjithashtu përgëzime kryetarit dhe ekzekutivit të kaluar për një punë jashtëzakonshme që kanë bërë dhe po shihet edhe me tejkalimin e të gjitha parashikimeve të oponentëve tanë për të hyra vetanake dhe punën që e kanë bërë. Kështu që ne emër të grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ekzekutivit të ri i dëshirojmë punë të mbarë dhe shumë suksese.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë dhe gjithashtu e përgëzoj drejtorin e financave për sjelljen e këtij raporti ku janë të specifikuar edhe krahasimet që janë bërë me vitet paraprake për me pae se si kanë shkuar punë. Unë isha ndal vetëm të dy çështje kryesore që për mua dhe situatën normale janë esenciale për funksionimin normal të një institucioni e ku po flasim për komunën e Rahovecit. Për vitin 2021 kemi pasur një planifikim prej 1,069,933 euro tek tabela 1,5 ku shihet që tek të hyrat normale vetanake kemi një tejkalim prej 1,172,638 euro dhe kjo është diçka e mirë që po i ndodhë komunës tonë, pasi nëse kemi mungesë të hyrave vetanake atëherë kemi edhe mungesë të realizimit të projekteve që ndikon direkt në jetën e qytetareve dhe këtu është e mira pasi është tejkaluar plani i të hyrave të rregullta vetanake pra fjala është për vitin 2021. Edhe diçka tjetër shumë me rëndësi që është për funksionimin normal të një institucioni dhe shumë jetike e kemi shpenzimin e buxhetit. Ky kuvend çdo vite e aprovon buxhetin për vitin pas ardhës dhe ai buxhet nëse nuk shpenzohet drejt atëherë është e kotë edhe aprovimi për arsye se ato investime nuk shkojnë tek qytetaret. Kështu që e shohim se për vitin 2021 kemi pasur 98,67% shpenzim të buxhetit dhe kjo është për me u përgëzua për arsye se është bërë një punë shumë e mirë pasi ky buxhet që aprovuar ju është kthyer qytetareve të legjislaturës se kaluar. Po ashtu një e mirë tjetër tek shpenzimi i buxhetit, tek investimet kapitale e kemi një përqindje goxha e lartë mbi 96% që rrallë ndodh tek komunat tjera por të komuna jonë kjo është bërë si diçka normale që buxheti me u shpenzue në mënyrë të drejtë dhe në kohë. Po ashtu të nënkategoritë e tjera që kanë ndodhur pasi ka tejkalime të realizimit të të hyrave dhe shpenzime me kohe të buxhetit por unë i përmenda vetëm këto dyjat dhe e kisha përgëzua drejtorin e financave për këtë raport që është kujdesur për shpenzimin e buxhetit dhe po ashtu edhe gjithë drejtoret e ekzekutivit të kaluar pasi janë marr me shumë me shpenzimin e buxhetit për vitin 2021.

Artan Asllani – Përshëndetje kryesues, kryetar, drejtor, kolegë asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Unë desha të ndalem të raporti financiar që është sjellur nga drejtori i financave Afrim Limani, ku desha të theksoj që përkundër faktit dhe vështirësive që kanë ndodhur gjat vitit 2021 për shkak të pandemisë, komuna e Rahovecit në bazë të planifikimit i tejkalon ne planifikimit të realizimit të buxhetit. Edhe përkundër faktit që me vendim të kuvendit të komunës së Rahovecit gjat periudhës së vitit të kaluar të vitit 2021 janë marr shumë lehtësira rreth lehtësimit nga taksat komunale të komunës së Rahovecit edhe pasi që ka bërë planifikimin gjat muajit mars ka bërë lehtësira rreth lirimit të taksës komunale, ku buxheti i planifikuar për këtë kategori është liruar për 90% të bizneseve. Gjithashtu duhet me pas ne konsideratë se është marrë vendim për lirim nga qirja për mbi 50% të të gjitha biznesve ku në këtë nën kod ka pasur një planifikim që ndoshta ka mundur të shkojë edhe minusimi në këto kategori. Po ashtu ka pasur lehtësira si në prona komunale dhe hapësirat e jashtme dhe

ne toka. Në përgjithësi nëse shkojmë edhe tek raporti i inkasimit të të hyrave komunale vetanake e shoh që është bërë një realizim mjaft i mirë e poashtu edhe të shpenzimit të buxhetit për vitin 2021 ndërsa për këtë vit që shpresojmë që për shkak të pandemisë të mos kemi vështirësi në jetën e përditshme në jetën e përditshme dhe atë të biznesit për shkak se një e mirë në realizimin e buxhetit vjen edhe nga bizneset e komunës së Rahovecit.

Sinan Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë. Desha të ndalem tek raporti financiar tek krahasimet që janë bërë për planifikimet dhe realizimet për kodin ekonomik 50409 me theks të veçantë tek çerdhet me bëri përshtypje ku thotë participim, arsim çerdhja e fëmijëve, që me jep me kuptim se është vetëm një çerdhe ku janë planifikuar 10,000 euro kurse janë realizuar 34,425 euro që i bjen 150% me shume dhe me bëri përshtypje që me kalkulimin tim edhe pse nuk jam i mirë në matematikë ku 9000 e vijojnë atë çerdhe ku me një kalkulim të thjeshtë i bjen ka 30 euro me participime fëmija dhe që i bjen që për 12 muaj kjo shifër duhet me dalë dhe mua me intereson fakti kjo shifër ka dalë e paplanifikuar edhe a u zbatua udhëzimi administrativ që një edukatore sa fëmijë duhet me i pas në përkujdesje mbikëqyrje apo edukim. Kështu që për mendimin tim nuk ka pasur punëtor të rinjë në çerdhen faktike që ekziston në Rahovec, meqenëse konkurset kanë dalur tash për këtë vit, kështu që desha me ditë se a u zbatua udhëzimi administrativ dhe gjithashtu në të njëjtën faqe me bo një krahasim 50026 taksë për legalizimin e objekteve ku janë planifikuar 28,000 euro kurse realizime 10,000 euro, që i bjen që komuna nuk mundet me marr të hyra pa planifikuar nga ndërtimet pa leje që ka në numër të madh ndërtime pa leje.

Afrim Limani – Faleminderit shumë për pyetjet dhe gjithashtu kërkoj falje që nëse eventualisht nuk kam mundur ndonjë pyetje me shënuar mirëpo mund të ju pergjigjem në mënyrë interaktive. Edhe pse shumica nga ju jeni në mandatin e parë dhe në mungesë të informatave rreth financave dhe mund të bëni ndonjë pyetje jo të duhur, por të Burim Krasniqi kjo nuk qëndron pasi ka qenë edhe njëherë tjetër asamblist. Leonard Morina parashtroj disa pyetje dhe bile fjalën dështim e keni përdorur edhe pse nuk qëndron ashtu mirëpo paraprakisht dua të ju them diçka, pasi të hyrat janë me të vogla se vitin e kaluar dhe unë nuk e konsideroj këtë dështim nëse të hyrat në raport me vitin e kaluar janë për me pak se 10,000 euro dhe ju vazhdimisht në të gjitha pyetjet që keni bërë i quani dështim dhe nëse konsideroni dështim atëherë të gjitha planifikimet që janë bërë në kuadër të programeve ekonomike dhe pse nuk qëndron ashtu siç ju e konsideroni si dështim. Me rastin e planifikimit dhe kur vjen qarkorja buxhetore që ju do ta vëreni me vone aty caktohen edhe tavanet buxhetore se sa i ka komuna e Rahovecit në buxhet në kategori brenda vitit të ardhshëm po supozojmë për vitin 2023. Mirëpo aty caktohen edhe limitet për të hyra vetanake dhe ata i kanë caktuar shumën që e kemi pasur 1,061,000 euro edhe mbi bazën e kësaj edhe nga përvoja që kam krijuar e di afërsisht se sa mundemi me realizue të hyra në kuadër të një kategorie ekonomike dhe në të gjitha kategoritë në jemi të detyruar me i ulë të hyrat sepse vetëm me arrit shumën prej 1,061,000 euro dhe sigurisht që kemi dal jashtë planifikimit real që duhet me qenë, pra në këtë drejtim jemi të detyruar me dështua dhe sigurisht që me vonë do ta kuptoni edhe ju vet se si rrjedhin këto procese. Tek zyra e kryetarit shpenzimet e telefonisë mobile, në e kemi një kontratë pra një pako që janë të specifikuar se ka shpenzime zyra e kryetarit, zyrtarë e drejtorive edhe të gjitha janë të përcaktuara në pako dhe jashtë asaj pako nuk mund të dalim. Pastaj shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit, këtë pyetje kanë parashtuar Leonard Morina edhe Burim Krasniqi. Natyra e shpenzimit është asisoj që janë të përcaktuara edhe kodet ekonomike se ku shkon ky shpenzim dhe për dijenin e juaj shpenzimet e udhëtimit zyrtar janë kryesisht bartja e nxënësve. Pra komuna e Rahovecit ka disa kontrata që e bëjnë bartjen e nxënësve anasjelltas që këtë me mirë e din edhe drejtori që janë mbi 4-5 kontrata për bartjen e nxënësve dhe ky shpenzim kështu që ky kod lidhet kryesisht me bartjen e nxënësve. Pastaj pyetje tjetër ishte rreth obligimeve të mëdha kontraktuale që bëri Leonard dhe Burimi dhe përgjigja vlen për të dytë. Është e vërtet që kemi obligime të mëdha kontraktuale por në kemi edhe mundësi financiare me i mbulua këto projekte, kështu që mund të ju them lirisht kemi stabilitet financiar që në afate të caktuara kohore mundemi me i mbulua të gjitha këto shpenzime. Ky kuvend në shtator të vitit 2021 e ka votuar një buxhet prej 16,000,513 euro, ku në këtë buxhet janë përcaktuar edhe projeksionet për vitin 2023-2024 dhe vetëm këto dy projeksione pra për

investimet kapitale 2023-2-2024 që bëjnë ne total prej 11,700,000 euro, që do të thotë se ne kemi mundësi që të gjitha këto kontrata apo obligime që i kemi bo atëherë kemi mundësi financiare që deri në fund të vitit 2024 me i mbulua me financa këto projekte dhe duke ja shtuar edhe projektin rreth sheshit qendror, ne e kemi paraparë atë projekt e kemi qitë në projeksionet buxhetore me mbulua të paktën 80% të atij projekti. Sa i përket obligimeve financiare e kemi një gabim teknik pasi shumicën e kontratave i kemi mbulua por ka ngelë pjesa tjetër që me këtë buxhete të vitit i mbulojmë dhe një pjesë të madhe të këtyre kontratave që janë në vazhdim. Tek shpenzimet në kuadër të zyrës së kryetarit, duhet ta dini se janë edhe disa zyre tjera që operojnë në kuadër të zyrës së kryetarit siç janë zyra ligjore, zyra e prokurimit, zyra e auditorëve por janë edhe disa të tjera që bëjnë shpenzime dhe ai buxhet ndahet për atë. Të gjitha shpenzimet këshillëdhënëse, të gjitha këto shpenzimet pra mëditjet që ju paguhen anëtareve të komiteteve pra të gjithë ata që janë zgjedhur në komitete janë brenda këtyre shpenzimeve. Sa i përket shpenzimet për dreka zyrtare nuk kemi shume dhe i kursejmë në maksimum këto dhe në kur i kam parë vërtet nuk jam ndie mirë pasi me hëngër pa krye obligimet financiare por të them të drejtën se faji është të operatorët sepse me vonë i ka sjellë faturat pasi është mbyllur viti fiskal. Sa i përket furnizimit me ujë në fshatin Senoc e kemi drejtorin e shërbimeve publike që mund të ju jep përgjigje rreth kësaj.

Burim Krasniqi – Desha me ditë që në raport pse nuk janë përfshirë obligimet e pritshme në bazë të procedurës ligjore si një lloj rreziku që mund të na shfaqet dhe gjithashtu të obligimet kontraktuale ndër vite, që realisht nuk janë për fajin tuaj por të disa qeverive por megjithatë janë dhe duhet me i marr parasysh.

Afrim Limani – E vërtet që kemi borxhe ndër vite, e poashtu kemi borxhe edhe nga viti 2012 kështu që në seancën e radhës në muajin shkurt do të sjellim si pikë të rendit të ditës bartjen e mjeteve dhe aty ne duam me i mbulua disa borxhe nga viti 2012 ashtu siç e thatë edhe ju, mirëpo këtë shume këto borxhe të mëhershme i mbulojmë me bartje të mjeteve, kështu që duhet ta dini se faji nuk është të na por faji është kryesisht të operatori, pasi në zakonisht marrim projekte edhe nga ministria e financave pasi nuk është e logjikshme një borxh i mëhershëm me figurua pasi në nuk mund ta fshehim por besoj që brenda këtij viti deri në vitin 2017 që realisht janë të vogla pjesë pjesë do të shlyejmë deri në vitin 2020 dhe kështu do të kemi stabilitet financiar. Poashtu procedurat gjyqësore në këtë raport nuk i ke futur mirëpo ato barten në pasqyrat financiare dhe pasqyrat financiare janë publike dhe mund të i shihni të gjithë edhe këto raport mundeni me pae në pasqyrat financiare pasi është rregull me ligj që me figurua në pasqyrat financiare. Gjithashtu Besen, Artanin, Hasanin i falënderoj për të gjitha pasi keni qenë pjesë e proceseve dhe i dini këto. Po ashtu në pyetjen e parashtruar nga Sinani ndërlidhet ajo që thash me herët rreth huqjes në planifikim, po ashtu edhe pyetja e parashtruar rreth taksës për legalizim pasi vërtet është shume problem me ja qellue edhe kemi prit bashkërisht që planifikimi i buxhetit na kanë ndihmuar edhe disa ish asambleist të PDK-së dhe kemi mendue se do të kerkesë me shume e qytetareve për legalizim dhe në këtë drejtim ja kemi huqur.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, drejtoret e drejtorive, anëtarët e kuvendit, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit. Të nderuar anëtar të kuvendit, mendoj se sukses është tejkalimi i të hyrave dhe madje në një masë bukur të madhe gjithashtu sukses është realizimi apo shpenzimi i buxhetit e gjithashtu sukses është raporti i paraqitur me kohe edhe pse pritet me u bartë disa të dhëna në pasqyrat financiare dhe për këtë gjë e falënderoj drejtorin z. Afrim Limani dhe poashtu sukses i këtij kuvendi dhe i përbërjes së kaluar të kuvendit është që për shkak të pandemisë në kemi liruar plot biznese nga taksat komunale, taksat afariste dhe ky është një sukses që në një mënyrë apo tjetër ju kemi ndihmuar bizneseve. Gjithashtu sukses është edhe kur ky kuvend ka vendos me i dhanë në shfrytëzim pronat komunale në afat të caktuar dhe normalisht që për shkak të pandemisë në nuk e kemi ngarkuar situatën sepse ka vendime të kuvendit dhe ata që janë kon në përbërjen e kaluar e dinë këtë, gjithashtu sukses është me realizua planin e të hyrave e madje edhe me tejkalua e ju do ta shihni në bartjen e të hyrave se sa është tejkaluar plani edhe për faktin se kemi pandemi e gjithashtu se ka vendime të kuvendit diku 50% janë hequr taksat, por mos harroni se ka një vendim të qeverisë ku hiqet kushtëzimi nga tatimi në pronë prandaj mos të çuditeni dhe asnjëri prej anëtarëve të kuvendit e sidomos këta që janë të ri e ma vonë do ta kuptojnë se çka është saktë dhe cila është e vërteta dhe cili është realiteti dhe

raportet financiare që sigurisht që bëhen publike dhe janë transparente dhe përgëzoj drejtorin e financave edhe për transparencën e treguar sepse ju e patë edhe disa shënime që nuk do të thotë që favorizojnë pozitën por i japin mundësi opozitës me diskutua, kështu që edhe kjo është një sukses sepse normalisht që kemi mundur me sjellë disa të dhëna me të pakta dhe ne për hire të transparencës pasi jemi komuna me transparente në Republikën e Kosovës e gjithashtu me performancë qëndrojmë mjaft mirë dhe ne e dimë se çka i ofrojmë kuvendit dhe e kemi për obligim me ju ofrua edhe ato shënime apo të dhëna që nuk na pëlqejnë neve. Pra planifikimi i të hyrave besoj që e kemi pa që sivjet kemi 1,300,000 euro dhe ne vet kemi kërkuar dhe kemi bërë presion që me rrit planifikimin por vendimin se cila është vlera monetare e të hyrave të planifikuara nuk e marrim ne por e marrim në partneritet apo bashkëpunim të thellë e madje me mundësi me të madhe vendimmarrje nga ministria financave, pasi ata e përcaktojnë tavanet apo limitet dhe besoj që ata që janë asamblistë të mëhershëm e dinë edhe këtë fakt ose ata që janë për herë të parë asamblistë sigurisht se kanë me mësuar shumë shpejtë këtë, pasi është qarkorja e parë buxhetore pastaj qarkorja e dytë e po ashtu edhe qarkore e tretë buxhetore që sigurisht që i mësojnë me kohë. Po ashtu drejtori i Financave e paraqiti edhe plot aspekte që lidhen me sqarimin e plot situatave që dikush edhe mundet edhe mos me i kuptua dhe sigurisht që kanë faj pasi i dëgjojnë për herë të parë dhe njëkohësisht i përshëndes edhe asamblistët e ri që bënë betimin sot, kështu të gjitha ato që i përmendi Leonardi si dështime, unë mendoj se ato janë suksese të qeverisjes së kaluar dhe në një vit me pandemi dhe zgjedhor dhe ta shpenzosh buxhetin për investime kapitale ose në total 98,67% është një e arritur e madhe që po ashtu neve na jep mundësi që me fitua grant, pasi njeri nga kriteret që me fitua grant qoftë në performancë e qoftë edhe në grante të brendshme nga qeveria apo donatorët është përmbushja e kriterit 75% të shpenzimit të buxhetit dhe mos të harrojmë se ne kemi realizuar 98,67% që është një e arritur dhe e jashtëzakonshme në një situatë pandemike ku të gjithë e dini që ska bord të OSHP-së dhe me mbërrit me i krye të gjitha procedurat e prokurimit dhe me menaxhua me një situatë ku ska bord edhe ku vendimet e OSHP-së edhe kur ka bord zakonisht vonohen por me mbërrit me i tejkalua të gjitha këto dhe këtë sukses, atëherë unë e falënderoj gjithë ekipin që e kam pasur në mandatin e kaluar dhe po ashtu e përgëzoj drejtorin e financave që ka mbërrit. Pastaj të pyetje a parashtruar për çerdhet, sikur po harron dikush që numri i fëmijëve është shumëfishue në çerdhe dhe kjo është lajm i mirë edhe ne kemi kërkesa edhe me tutje për çerdhe të reja, ne kemi 3 çerdhe të reja pothuajse të gatshme mirëpo kemi mungesë stafin por edhe mos të harrojmë se ka edhe shtimë të numrit të stafit në çerdhen e fëmijëve Tulipanët në Rahovec. Neve nuk na ka lejua qeveria me rrit numrin e edukatoreve mirëpo kemi gjetur forma të përkohshme. Kështu që i ftoj anëtarët e kuvendit që të përpiqen e të përkushtohen që të marrin të dhënat edhe të informohen pasi me lehtë do të kuptojnë gjërat. Por ajo që është me rëndësi që ky raport financiar shpenzimet për darka dhe dreka, shpenzimet e telefonit shpenzimet e tjera të qeverisë komunale janë brenda planifikimit. Me ka ndodh njëherë në mandatin e parë kur drejtori i financave është thirrë në prokurori për shkak se nuk janë planifikuar mirë shpenzimet për dreka darka telefona dhe ka dhënë sqarimin pse. Kështu që tash jemi në situatë të planifikimit dhe nuk ka asnjë arsye me u shqetësua dikush e bile me pa që plot shpenzime dalin që anëtarët e kuvendit i kanë bo si dreka darka pastaj aktivitete të drejtorisë komunale të arsimit të drejtorisë për kulturë rini dhe sport mirëpo unë personalisht nuk ka ndodh që me krijua një shpenzim që reprezentacionin me përdor që me hëngër drek të restoranti Haxhijaha siç e kanë përdor dikush përpara dhe me pastaj ne kemi pague kur e kemi marr pushtetin. Të legalizimet ka plot objekte nuk mund të legalizohen edhe futen në listën e pritjes, kështu që ne e kemi zyrën për legalizim dhe i kemi dhënë prioritet mirëpo arsye pse futen në listë të pritjes për shkak se nuk i plotësojnë kriteret, pasi janë të ndërtuara jashtë planit urbanistik ose janë të ndërtuara në komasacion edhe pse kanë dëshirë me legalizua mirëpo nuk guxon askush, pra janë të përcaktuara me ligj. Ne kemi pasur edhe unë kam besua që shumë të hyra kemi me i rrit me legalizime por kaq ishin mundësitë por ne do të japim prioritet edhe tash legalizimit të objekteve të cilat nuk mund të pajisën me leje ndërtimi mirëpo mund të legalizohen, pasi natyrisht se jam i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm dhe të gjithë ne të informuar se ka ndërtime çdo ditë mirëpo për me u pajisë me kushte ndërtimore dhe leje ndërtimi sigurisht që ka edhe udhëzime të qarta dhe rregulla të lojës që kanë të bëjnë me pronën dhe plot çështje të tjera. Por për legalizime

jemi te interesuar edhe tash me vazhdua edhe tash këtë projekt sepse mendojmë se mund te ketë te hyra edhe nga legalizimet. Tek obligimet kontraktuale, ju e dini që kam fitua besimin me punua dhe nuk do te ndalem se punuari asnjëherë, pasi si kryetar komune nuk i takoj atij koncepti që me pika diçka nga qielli, por angazhimi jonë pasi kemi obligime kontraktuale për 2,3 dhe 4 vjet, kështu që besoj që do të mbërrimë me i menaxhua per shkak se plot aktivitete tjera plotësuese që do te na ndihmojnë pasi ne kemi me fitua grante tash se shpejti dhe gjithashtu edhe gjate vitit 2021 kemi fitua grante dhe plot prej aktiviteteve që i kemi planifikua me financa nga kuvendi i komunës duhet me i ridestinue për shkak se fitojmë grante për projekte te cilat i kemi ne regjistrin apo listën e projekteve kapitale. Obligimet financiare janë ato që janë dhe nuk fshehën dhe sigurisht se raporti nuk është i plotë për shkak se ende nuk është bërë barazimi nga thesari dhe tek atëherë mund te dimë se sa kemi edhe obligime apo vendime gjyqësore dhe po besoj që brenda muajit shkurt kur te bohet barazimi i plotë atëherë n mund ta dimë saktë se ku jemi. Se ai përket vendimeve gjyqësore, normalisht se komuna jonë paguan vendime gjyqësore siç kanë paguar edhe ne mandatet tjera pasi njerëzit e kanë te drejtën e vet dhe për te drejtën e vet ushtrojnë padi edhe aktivitete ne gjykatat. Ne kemi kemi përfaqësuesin ligjor apo avokatin e komunës i cili është i autorizuar me i mbrojte te gjitha çështjet me interes te komunës sipas ligjit ne interes te komunitetit dhe te komunës. Këto janë beteja ndërmjet institucioneve, sigurisht se edhe fitojmë edhe humbim mirëpo me vonë. Te borxhet e vjetra, unë pajtohem me atë që e dha Afrim Limani dhe asnjë koment me tepër mirëpo ka operatore që nuk përgjigjen fare, që nuk ka situacion apo nuk është ne rregull dhe ato gradualisht ne proces i shtyjme pasi ju e keni pa që ka borxhe që nga viti 2012 e tutje dhe te gjitha këto me kujdes te shtuar i shqyrtojmë dhe besoj që nuk e qojnë punën deri aty sa me shkue te procedura përmbartimore, kështu që mos harroni se ne raportojmë ne ministri te financave dhe drejtori për buxhet dhe financa z. Afrim Limani por edhe zyrtari kryesor financiar raportojnë edhe ne baza mujore edhe ne baza tre mujore pasi kjo është e rregulluar me ligj. Pra kurrkush nuk mundet me shkaktua apo me pas ndonjë dilemë se ka është duke shkuar komuna dhe ne jemi për me punua këtu secili ne punën e vet secili ne konceptin dhe te drejtën që e përfaqëson pasi edhe me dashtë me dërgua komunën ne bankrotim nuk mundet pasi këtë nuk e lejojnë ligjet dhe kjo temë është e qartë. Ne mundemi me pas situatë problematike me kontratën kolektive që është e vërtet dhe ju keni dëgjua se ne kemi ngrit zërin edhe ne asociacionin e komunave edhe njëherë dhe kemi kërkuar me urgjencë që ministria e financave dhe ministrinë e arsimit që ti japin mundësin komunës që me alokue buxhet për përmbushjen e kontratës kolektive ne arsim dhe shëndetësi ose le ta marrin përsipër që ta paguajnë vet këtë shume ose le ta fusin ne ligjin për paga që pritet me u procedua shume shpejt sepse nga kontrata kolektive krejt ato çka burojnë nga zbatimi i kontratës kolektive kanë te bëjnë me paga dhe mëditje pra la ta fusin ne ligjin e pagave dhe njëherë e mirë që ta sqarojnë, pasi edhe nëse krejt buxhetin e komunës se Rahovecit e qojmë ne përmbushjen e kontratës kolektive dhe këtë punë e kish te kryne komuna e Kaqanikut mirëpo ajo çdo vit derivon dhe nëse ne e marrim përsipër dhe themi se per vitin 2021 e kemi përmbushur kontratën kolektive atëherë na dalin disa benificione dhe situata te reja ne vitin 2022 dhe krejt buxheti mundet me te shkua, nëse nuk përfshihet ne ligjin për paga që shpresoj që ka një momentum dhe një masë kritike që po lypet sa me shpejt dhe ka zotime që do te bëhet atëherë ne do te detyrohemi që krejt buxhetin për investime kapitale ndoshta me harxhua ne përmbushjen e kontratës kolektive që besoj që secila komunë e ka problem dhe secila komunë po reagon ne mënyrën e vet sepse ka rreziqe. Pra kontrata kolektive ka rreziqe dhe unë e kam thënë para opinionit publik se jam për kontratën kolektive dhe jam per me i përmbush te drejtat dhe detyrimet që kanë palët për me u zbatua kontrata kolektive edhe ne arsim dhe ne shëndetësi mirëpo duhet ta kemi sinjalin e qarte nga ministria e financës që ku do ti marrim mjete dhe a do te kemi mjete për me fillua përmbushjen e kontratës kolektive se a do të na japin neve apo do ta bëjnë vet ata. Sa i përket drekave dhe darkave te papaguara, ne kemi situata te ndryshme pasi kemi edhe restorante që kanë probleme që edhe faturën me ta kompletua dhe unë po besoj që nuk i kemi hy ne hak askujt me obligimet që eventualisht kanë mundur me u krijua për fundvit e ndoshta edhe për me herët. Të obligimet kontraktuale edhe njëherë ju them se kam ardhë me punua dhe besoj që jemi dakord te gjithë me këtë parim por normalisht që i mbetet qeverisjes komunale dhe kuvendit te komunës te bëjmë një debat te gjërë dhe te thellë që sa me

mirë te menaxhohen dhe sigurisht që edhe buxheti të shpërndahet sa më drejt dhe përgjegjshëm dhe të shpenzohet në përputhje me ligjin. Por mos harroni se kam edhe objektiva synime dhe prioritete të zotime dhe normalisht se për këtë kam marr edhe besimin e qytetareve, kështu që jam shumë i interesuar me i shtyje proceset përpara por kuptohet në bashkëpunim me kuvendin e komunës, kështu që deri me tani nuk kemi pasur ndonjë situatë sfiduese apo problematike saqë me thanë që me dërgua komunën në bankrotim dhe për këtë të jeni të sigurt se nuk mundeni me qua në bankrot komunën e Rahovecit dhe asnjë komunë të Kosovës sepse nuk e lejon ligji por edhe mekanizmat e kontrollit që për fat të mirë nga viti në vite po rritet dhe po thellohet, e po ashtu e kemi zyrën kombëtare të auditimit që nuk na lejon me qua komunën drejt bankrotimit. Sa i përket ujit të pijshëm në fshatin Senoc, e dimë që ujë të pijshëm nuk ka dhe ne kemi bërë një shpuarje në bashkëpunim me KRU. Gjakova që realisht nuk ka dal ujë dhe për këtë kontrata ekziston, kështu që tash duhet me shtyje përpara një projekt i cili e sjell ujin nga fabrika e re e filtrave të përpunimit të ujit nëpër fshatin Polluzhë dhe duhet me ndërtua stacion të ri të pompave në Senoc dhe në Drenoc, pasi që nuk ka ujë të pijshëm alternativ në Senoc dhe për këtë situatë mundeni me pyet edhe banoret edhe kryetarin e këshillit të fshatit edhe të gjithë, ne kemi prue se mos po gjejmë pasi ka qenë edhe presion i madh që vitin e kaluar ska pas fare ujë dhe në bashkëpunim me Radoniqin 49/51% dhe kësaj radhe për ket pusin ne kemi shkuar në 51% kurse Radoniqi 49% pasi ata nuk kanë pasur planifikim për fshatin Senoc dhe ne kemi marr përsipër dhe kemi hapur procedurën dhe kemi realizuar një projekt që rezultojë si dështim për shkak të mos gjetjes së ujit të pijshëm. Dhe në fund unë do të rrisë shpenzimet e udhëtimit brenda vendit sepse ka edhe kërkesa tjera që janë në përputhje me udhëzimin administrativ që duhet diku 4 km me qenë distanca dhe sigurisht se ka edhe kërkesa tjera, pasi faktikisht nuk ka pasur edhe operator se i kisha përmëshur edhe me herët. Kjo rritje do të vjen për shkak se duhet shtie edhe shtëpinë e pleqve dhe pensionistëve dhe krejt ata që janë të interesuar gjithë transportin falas do ta kenë dhe sigurisht se kjo është një kosto për komunën e Rahovecit. Të planifikimet normalisht në ende jemi në pandemi dhe këto ditë jemi edhe me masa edhe me të ashpra dhe ajo që do të jetë sfida për këtë vit në raportin financiar të vitit 2022 do ta shini se do ta kemi sfida realizimin e të hyrave të tatimit në pronë, për shkak se qeveria jonë ka hequr kushtëzimin me lidhe me pagesën e tatimit në pronë me vërtetimin e regjistrimit të automjeteve, pasi ka qenë se nuk ke mundur me regjistrua pa e krye pagesën e tatimit në pronë dhe tash është hequr ky kushtëzim, kështu që nëse nuk kemi mekanizma të kushtëzimeve vështir do të kemi me realizua ato të hyra të tatimit në pronë që i kemi pasur në vitin 2021. Unë mendoj se qeveria e ka menduar mirë këtë se çka nëse nuk paguajnë njerëzit pasi tatimi në pronë është i vetmi tatim që nuk hiqet dhe nëse i qon tek përmbuesi atëherë i qon ministria e jo në si komunë për shkak se vendimi është u qeverisë. Kjo sigurisht se e ka lehtësuar punën kur ke hequr kushtëzimin por pasi komuna e Rahovecit është një ndër komunat që vështir e mbledh tatimin në pronë pasi në komunë të Prizrenit ky nuk është një problem pasi kanë traditë sa i përket pagesës së tatimit në pronë. Kështu që nëse edhe në hymë me organizatën Jica e cila është një organizatë japoneze e cila merret me menaxhimin e mbeturinave dhe mjedisit dhe nëse futet edhe komuna jonë ku të hyrat nga mbeturinat nga sektori që krijohet këtu natyrisht se do të rriten të hyrat pasi që në llogaritim që me pagua 3,20 cent operatorin ndërsa 1,30 cent me mbet takse komunale dhe nëse Ekoregjioni mbi 600,000 euro mbledh mbeturina në vite atëherë edhe komunës sonë do të sjellë një burim të ardhurave nga taksa që do të krijohet. Kështu që nëse hymë në këto mekanizma apo burime të reja të hyrave atëherë ne kemi me përmësh planin e të hyrave për këtë vit. Por mos të harrojmë se 1,479,000 janë të hyra që i ka realizua qoftë të rregullta apo të jashtëzakonshme për një vit. Në pandemi me vendimin për lirim nga taksat komunale me vendimin e kuvendit jo të kësaj përbërje me heqjen e kushtëzimit nga ana e ministrisë së financave ne kemi mbërrir me tejkalua dhe kjo është shumë sukses i madhe dhe kjo i ndihmon komunës tonë që me operua suksesshëm edhe në përmëshjen e planeve tjera dhe synimeve tjera për këtë vit. Dhe tash ne do ta shohim se sa është i rëndësishëm përmëshja e kriterit e madje edhe tejkalimi i shpenzimit të buxhetit 98,67 % e bile edhe i vetmi presion që i kam bae drejtorit të financave Afrim Limani që se kemi përmësh 99,99% që realisht ska mundësi dhe ju nuk mund ta gjeni një komunë në Kosovë që ka mbërrir 98,67%.

Burim Krasniqi – Tek çështja e bartjes së nxënësve pajtohem plotësisht dhe e përgëzoj për punën që është bërë dhe do të ishte mirë me largua nga kodi buxhetor të shkrimit udhëtime zyrtare brenda vendit por të jetë kompensimi i transportit për bartjen e nxënësve apo të pensionistëve dhe jo me figurua si udhëtime zyrtare brenda vendit dhe figuron në kod buxhetor si bartja e nxënësve. Kështu që meqenëse drejtori nuk është i pranishëm është hendikep ajo që po e diskutojmë tek raporti financiar që nuk pata mundësi me cekë me herët, pasi janë 508,849 euro ku thotë shërbime kontraktuese tjera, pasi është vlerë shumë e madhe për me rrumbullakësua me një kod të përgjithshëm shërbime kontraktuese tjera 508,000 pasi kap 10% të investimeve kapitale apo 5% e buxhetit të komunës së Rahovecit d.m.th. duhet me qenë me e specifikuar. Gjithashtu shqetësimi i fundit është pasi drejtori e tha se ne e kemi llogarit mirë që kanë ndodh obligime kontraktuale të raportuara janë të mbulueshme financiarisht deri në vitin 2024 dhe pajtohem me këtë pasi nuk po besoj që është diçka e pambulueshme por në buxhetin e vitit 2022 ka kode të reja disa milionëshe, atëherë a nënkupton kjo që kryesuesi, kryetari dhe KPF-ja në diskutimet publike për buxhetin e vitit 2023-2024 nuk do të ketë mundësi kode të reja por do të ketë vetëm diskutim publik për kode ose për kontratat aktuale të nënshkruara, pra kjo është shqetësimi që po mundem me shpreh dhe çuditë prej vetvetes që komuna në asnjë rast mund të shkojë në bankrot në formën e buxhetimit dhe raportimit.

Kryetari – Faleminderit kryesues, e para po besoj që opinionit publik gjatë dëgjimeve e konsultimeve publike që do të bën Komiteti për Politikë dhe Financa por edhe kryetari i Komunës me drejtorët e drejtorive publike që e kanë një aktivitet të konsultimeve publike në çdo lokalitet dhe çdo lagje siç e kemi bërë zakonisht dhe gjithashtu shpresoj që pandemia nuk do të jetë pengesë për me i zhvillue këto aktivitete. Përmëshja e këtyre kontratave që i kemi të lidhura ka me na detyruar neve me mendue për opsione të tjera pasi të gjitha janë të parapara pasi i kemi edhe raportet nga dëgjimet publike dhe të gjitha janë të përfshira në kontratat që i kemi dhe tash lufta është se sa do të mundemi me hec shpejt në zbatimin e kontratave të cilat i kemi të lidhura. Sa i takon projekteve të reja normalisht që në këtu i interpretojmë kontrata e nënshkruara dhe sigurisht se kemi me lidh kontrata të reja edhe këto vitë edhe projekte të reja të cilat do të fusim në projeksionet buxhetore edhe sheshin qendror dhe perseri do ta vazhdoj luftën e perpjekjen me të gjithë ekipin tim dhe gjithë juve që sheshi qendror me u rikthye financimi nga qeveria dhe jo me ja harxhue buxhetit të komunës gjithë atë shumë të madhe dhe duhet me marrë persiper qeveria financimin e sheshit sepse është i vetmi qytet që ska shesh qendror dhe për këtë kërkoj edhe ndihmën tuaj dhe me bo njëfarë presioni pozitiv që ata me gjet formën që me u rikthye financimi i sheshit qendror dhe sigurisht se ne do të kemi projekte edhe të kësaj natyre si sheshi qendror por pastaj i fusim edhe projeksionet e 2023-2025. Kështu që kontratat e mëdha që priten em fillue mirpo ende nuk janë lidhur dhe ato normalisht se futen në projeksionet buxhetore dhe në me kapacitetet buxhetore që i kemi sigurisht se i planifikojmë dhe i fusim në projeksionet buxhetore. Sa i takon shqetësimeve të shërbimeve kontraktuale, pasi në kemi kompani që merren me higjienën apo pastrimin, me mirëmbajtjen e objekteve të komunës. Siç e dini se kodet nuk i bën as kryetari i komunës e as kuvendi i komunës pasi kodet i bën një mekanizëm tjetër që nuk ka të bëjë me ne, kurse kuvendi i komunës vetëm i emërton projektet dhe i paraqet synimet dhe prioritetet që do të bëhen, kështu që z Burim Krasniqi është me përvojë dhe ka punue gjatë edhe në institucionet lokale dhe qendrore dhe këto gjëra i dinë me se miri se kodet nuk i bëjmë ne. Por a duhet me dhanë sqarime drejtori i financave në raport se çka janë shërbimet kontraktuale dhe duhet të i sqaroj këto mirëpo këtij kodit nuk mundet me i qitë edhe nën kodë tjera pasi ashtu janë të parapara dhe të precizuara nga shërbimet kontraktuale të tjera. Sikur të isha në departamentin e buxhetit apo deputet i kuvendit të Kosovës kisha kërkuar që shumë ligje me i bo plotësim ndryshime pasi nuk i përgjigjen situatave konkrete që operojmë në bashkë. Mirëpo këto janë kode që janë të përcaktuara diku tjetër dhe une e ftoj drejtorin e financave të specifikoj se çka përmban ky kodë për informacion për qartësi për transparencë është mirë me bo dhe në vazhdimisht e kemi edhe në këto katër vitet që shkuan sepse kuvendi i komunës ka kërkuar këso sqarime me pas vazhdimisht edhe normalisht se tani janë zyrtare por janë sqarime zyrtare të cilat tregojnë se çka përmban ai kod apo një kodë tjetër.

Leonard Morina - Faleminderit kryesues, unë vetëm desha me u ndërlidh me kryetarin se nuk janë dështime por janë te arritura te gjitha ato që u përmendën me herët mirëpo drejtori i Financave Afrim Limani e e tha që janë dështime mirëpo për shkak te limiteve jemi për me qëndrua brenda limiteve te përcaktuara dhe tash nuk po di a me i besua drejtorit apo kryetarit se a janë dështime apo nuk janë. Gjithashtu edhe një gabim teknik te zyrja e kryetarit tek shpenzimet me faqe 12 ku janë 5000 euro shpenzime dhe me siguri është gabim teknik pasi faktikisht vetëm 9045 euro janë shpenzime për vetura por me siguri është gabim teknik. Po ashtu desha tek kontrata e shkollave që tha janë udhëtime zyrtare dhe kontratat, pasi unë i kam pa kontrata dhe nuk po besoj që janë ne favor të komunës pasi ka kontratë që nxënësit e Rakovines barten që te vijjnë në Kramovik, kështu që sa është e drejtë dhe e arsyeshme kjo që ne me u kujdes për nxënësit e komunës se Gjakovës por nëse është për atë që me pas sa me shume nxënës atëherë pse nxënësit e Retijës i dërgojmë ne Radobravë apo ne Piranë, kështu që te dy kontrata i paguan komuna e faktikisht ne njërin i merr nxënëset dhe i sjell ne komunën tonë kurse tjetrën i merr nga komuna jonë dhe i dërgon ne komunën e Prizrenit d.m.th. njëra kontratë nuk është ne rregull dhe po besoj që nuk do te ishte mirë me dëmtua buxhetin e komunës dhe me i shërbye komunave tjera.

Kryetari – Kontrata e bartjes se nxënësve për ne shkollën e fshatit Kramovik është një kontratë që daton me shumë se 15 vjet dhe e trashëgojmë vazhdimisht, kështu që ne kemi tentuar që me marr përsipër ata mirëpo nuk e kanë marr serioze këtë punë, kështu që ata janë fëmijë tek e fundit dhe e kanë shkollën shume afër te Kramovikut kurse shkollën e territorin e komunës se Gjakovës e kanë shume me larg dhe ne këtë rast interesi është i fëmijëve dhe nuk është ndonjë shume e madhe që harxhon komuna e Rahovecit për bartjen e këtyre nxënësve por edhe ne te njëjtën kohe edhe fitojmë[pasi 2-3 mësimdhënës do te duhej te largohen nga puna për shkak te mungesës se orëve. Kështu që edhe ish drejtorët e arsimit e deri te drejtori i sotëm kanë bërë mirë që kanë veprua dhe duhet te mbështesim këtë mundësi për vijimin ne aktivitetin shkollor. Gjithashtu edhe ne fshatin Retijë funksionon kështu pasi Retija e Ulet nuk i sjell nxënëset ne shkollën fillore e cila gjendet ne Retijë te Epërme pasi zakonisht orientimi i tyre është nga Prizreni edhe ky fakt tash është i njohur dhe ai që është i asaj pjese nga Retija, Opterushe, Zoqisht, Krushë kryesisht orientimi i tyre shkon ka Prizreni dhe sigurisht se ne e kemi trashëguar dhe për shkak se janë shqiptar flasin shqip ritualet i kanë shqip traditat e zakonet i akne shqip mirëpo ndonjëherë dikush i trajton dikush si minoritet. Sa i takon asaj që a pata unë te drejt apo drejtori i financave se a ka kontradiktë ne këtë mes atëherë unë po besoj që ju nuk e keni kuptuar as njërin e as tjetrën dhe për këtë ska kontradikte se ne jemi te detyruar që ne momentin që na qesin limitin me i bo veprimet tona ne planifikim. Po ashtu jam shume i saktë që ne planifikimin që kemi bërë ne total dalim si tejkaluës te planit te hyrave madje tejkaluës 132% i kemi tejkaluës te hyrat e jashtëzakonshme.

Afrim Limani – Sa për sqarim, ne kemi dështuar për 10,000 euro ne relacion me vitin e njëjtë te periudhës se kaluar te vitit 2021 dhe nëse i fusim edhe gjobat e gjykatave dhe trafikut edhe këtë vit atëherë ne kemi tejkaluës dhe jemi plus 95,000 euro por nëse e bëjmë krahasimin ne raport me planifikimin dhe realizimin te rregullta bashke me gjobat e trafikut dhe gjykatave atëherë ne do te jemi mbi 400,000 euro. Kështu që këtë vit shuma e bartur që besoj që ne seancën e shkurtit do ta qesim si pike te rendit te ditës dhe do te jetë mbi 490,000 euro që kanë teprua dhe do te barten per vitin e ardhshëm dhe 10,000 ishte krahasimi i te hyrave te rregullta ne raport me vitin e kaluar.

Merisa Sharku-Vuçiterna – Përshëndetje për te gjithë. Një pikë që u prek me herët tani dua te zgjerohem pak me shume pasi që edhe i përkasë kësaj fushe. Ne faqe 6 janë te paraqitura te hyrat te realizuara sipas kodeve ekonomike nëpër sektorë, ku ne kodin 50002 takse për legalizimin e objekteve, ku planifikimi për vitin 2021 ka qenë 28,001 euro kurse realizimi i te hyrave ka qenë 10,643 euro që i bien 18,000 euro deficit. Kjo tregon një performancë jo te mirë ne këtë sektor apo thënë me mirë një mundësi e humbur për te kthyer këtë sektor një një burim te te hyrave financiare sipas shembullit që bënë komunat e tjera. Rahoveci është një nder komunat e pakta ne Kosovë e cila nuk ka krijuar një zyre te veçantë e cila merret me procesin e legalizimit, zyre kjo e cila merret vetëm me procesin e legalizimit e përbehet nga arkitektë ndërtimtarë, gjeodetë, inxhinierë te hidros, te elektros me kontrata te përkohshme. Duke pasur parasysh që komuna e Rahovecit ka

angazhuar vetëm një arkitekt për procesin e legalizimit dhe është normale që kampanja informuese ka qenë e dobët ose nuk ka ekzistuar fare me sa kam informacione une. Pas kësaj, pason që në vitin 2020 sipas publikimeve në faqen e komunës në urbanizëm figuron që vetëm 34 aplikantë që i kanë legalizuar objektet e tyre. Edhe pse përmendi kryetari listën e pritjes, por, edhe lista e pritjes nuk është aq e madhe që me arsyetua këtë çështje. Po ashtu problematike tjetër është që pak objekte janë legalizuar dhe ato që janë legalizuar nuk kanë përfundua si proces, për shkak se kanë mbetur vetëm në drejtorin e urbanizmit kurse me ligj është e paraparë që ato duhet me përfundua edhe me kadastrë që objekti me u përfundua si proces.

Kryetari – E para legalizimet, pronaret e objekteve të ndryshme vet kanë interes me i legalizue. Fushatë senzibilizuese në opinionin publik nga të gjitha mediat nacionale private dhe publike, ju e dini sa është zgjatur afati pastaj janë shtyre afatet dhe pronaret kanë pasur vet interes me i legalizua objektet e tyre. Ka disa rregulla të lojës, që e para e kemi zyrën për legalizime dhe është përdorur në kohën e fluksit të madhe dhe kur është pritur me shumë legalizime dhe kush nuk e din zyra për legalizime është në objektin e vjetër. Unë mundem me ju than se zyrtari i angazhuar për legalizime me kujdes të madhe në bashkëpunim me zyrtaret e urbanizmit e kanë krye këtë punë dhe e kanë krye me shumë sukses pa shkelur asnjë pikë të ligjit dhe normalisht sa i takon regjistrimit të kadastrit janë procedura ato, pasi në nuk mundemi me i legalizua ato ose me ju dhanë certifikatë dikujt pa një partneritet me Agjencionin Kadastral të Kosovës dhe pa i respektua deri në fund ligjet, pasi askënd nuk e lejojmë me gabue apo me i shkelë ligjet dhe e kemi për obligim me i tregua. Këtu e kemi edhe drejtorin e gjeodezisë z. Afrim Oruçi dhe ky e din me se miri kur regjistrohet dhe ju mund ta pyetni drejtorin e gjeodezisë për këtë se kur regjistrohet në kadastrë një prone apo objekt. Kështu që besoj që të lista e pritjes është ajo pasi që nëse nuk e ka dokumentacionin e plotë nuk mund të regjistrohet dhe shpresojmë që prioriteti për legalizimet do të jetë prioritet i madh edhe për këtë vit, kështu që shpresoj që qeveria nuk do të na thotë që stopone legalizimin por vazhdon ende.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar për të gjitha sqarimet, atëherë meqë nuk kemi të lajmëruar sa i përket kësaj pike. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve.

Kryetari – Sa për sqarim, unë jam dakorduar me ekipin tim që asnjë përgjigje nuk do ta japin në të njëjtën seancë, por në seancën e radhës do të marrin përgjigje prej secilit drejtor edhe prej kryetarit por nuk mundem me garantua për veten time, por, nëse dikush ka me pas arsye me paraqit ndonjë pyetje interesante që është urgjente atëherë nuk do të pritoj me dhanë sqarim por drejtorët nuk do të përgjigjen në atë seancë. Kështu që mundeni me bo pyetje me gojë apo me shkrim por në seancën tjetër e merrni përgjigjen.

Ilir Pallqa – Përhëndetje për të gjithë të pranishmit, së pari e uroj kryetarin, kryesuesin dhe drejtorët për pozitat. Urimin po e nisi me orën të cilin e kam përball në mur. Si për ironi kjo orë është duke e reflektuar mos punën në komunën tonë gjithë këto vite, orë e cila gjendet në mur është e ndalur. Prandaj unë ju kam sjellë si dhuratë një orë të re e cila punon, me shpresën që do punoni edhe ju.

Kryetari – Faleminderit shumë, është një dhuratë interesante por orën në sallë është dashur të ndërrojë kryesuesi i kuvendit. Por, unë mendoj se nuk ka më keq se sa t'i ndalet ora një djali ose një vajze të re sepse rrezikojmë të ardhmen. Tani të nderuar kuvendar dua ta prezantoj ekzekutivin, ju kërkoj falje që nuk i prezantova në fillim. Po ja filloj me nënkryetarin e komunës z. Fatmir Iska, drejtor i drejtorisë për buxhet dhe financa z. Afrim Limani, drejtoresh për shëndetësi dhe përkujdesje sociale znj. Saranda Sallteku, drejtor i drejtorisë për shërbime publike z. Përparim Krasniqi, drejtor për kulturë rini dhe sporte z. Afrim Dina, drejtor për ekonomi turizëm dhe zhvillim z. Erhan Morina, drejtoresh për punët inspektuese znj. Nora Boshnjaku, drejtor për urbanizëm planifikim dhe mjedis z. Albnor Mullabazi, drejtori për Gjeodezi kadastrë dhe pronë z. Afrim Oruçi, drejtori i drejtorisë për arsim z. Avni Morina dhe drejtori i administratës z. Besnik Hoti. Të gjithë janë të kualifikuar, kam bërë një ndryshim të kujdesshëm, nuk kam bërë ndryshim revolucionar, katër nga drejtorët janë drejtor të ri që nuk kanë qenë asnjëherë dhe katër ishe drejtorë janë kuvendarë dhe katër drejtorëve ju janë nderuar drejtoritë. Na ka mbetur edhe një drejtori pa drejtor shumë shpejtë edhe atë do e emërojmë. Ajo që desha të shtojë për fund është se ka diçka që është e ligjshme por nuk është parimore dhe

nuk është e ndershme, unë i kam dëgjuar debatet edhe në fillim të mbledhjes, është e drejtë e secilit që të lidhë marrëveshje me këdo. Sa i përket propozimeve për anëtar të komiteteve unë i kam të qartë, por njerëzit ndonjë herë ndoshta kanë edhe të drejtë të thonë që ka diçka që është e ligjshme por nuk është e ndershmë, më e ndershme është që dikush të kalojë nga një subjekt në tjetrin se sa propozimi i një anëtari në komitet që krijon paqartësi në opinionin publik. E di që përfaqësimi në komitetet obligative duhet të jetë politik, prandaj ju kisha lut si kryetar i komunës që jam që t'i reflektoni së paku politikat të cilat përfaqësohen nga partitë e juaja politike. Ju përshëndes dhe ju uroj suksese në punë.

Kryesuesi – Sa i përket këtij diskutimi unë kam një mendim ndryshe, ne të gjithë jemi kuvendarë të kuvendit dhe nuk kemi bërë ashtu siç e prezantove, mendoj se çdo gjë ka shkuar në rregull, janë themeluar dy komitetet obligative sipas legjislacionit në fuqi. Kurse sa i përket dhuratës të cilën na e ka bërë Iliri, e kam fatin unë që të pranojë këtë dhuratë, ne do e zëvendësojmë me këtë orë, shpresoj që edhe ekzekutivi do të punojë në ritmin e kësaj ore.

Burim Krasniqi - E kam një kërkesë dhe dy pyetje të cilat kërkojnë një sqarim, së pari i nderuari kryesues kishte me qenë mirë që anëtarëve të kuvendit sekretaria të ja dërgojë në email ligjin për vetëqeverisje lokale, udhëzimet administrative, rregulloren e punës së kuvendit dhe statutin e komunës. Kurse sa i përket pyetjes për drejtorin e arsimit se ku qëndron çështja me furnizim me drunjë sepse ka qenë shumë sfiduese për këtë vit, pastaj pyetje tjetër për drejtorin e shërbimeve publike, rruga Xërxë Rahovec është në menaxhim të komunës si projekt, e di që kjo rrugë ka probleme financiare, por kjo rrugë shfaq shumë rrezik në kuptimin e mungesës së sinjalizimit dhe sigurisë përgjatë kësaj rruge. E fundit i nderuari kryetar më duket si gjuhë e ashpër për një kryetar komune të përdorë fjalitë janë veprimet e pandershme të grupeve politike, fjala ndershmëri dhe pandershmëri konsideroj që është një ofendim dhe jo fjalë parlamentare e cila duhet të përdoret në kuvendin e komunës. Përderisa ne nuk bëmë në kundërshtim me ligjet në fuqi nuk e besoj se ne jemi duke bërë ndonjë pandershmëri, mendoj se fjala e përdorur nga ju është fjalë ofenduese për dy grupet e kuvendarëve që janë në kuvendin e komunës në Rahovec.

Kryetari – Fola shumë korrekt, konstatova një situatë të vërtetë, unë do ta shpjegoj edhe në terren që veprimet politike të kuvendit të komunës, pra të grupeve politike janë veprime të një koalicioni, por, mos hajdeni pastaj tek unë të ankoheni dhe të më thoni që i keni prishë marrëveshjet sepse ju vetë keni me i prish marrëveshjet. Unë e thashë në atë kuptim a ju pëlqeu apo ju nuk e di, por është e çuditshme dhe nuk e di a ka ndodhë në kuvendin e Republikës së Kosovës, e as në ndonjë komunë tjetër që të propozohet kandidati i ndonjë grupi tjetër politik, ju uroj që të ju shkojë mirë kurorëzimi por besoj se shumë shpejtë keni me u shkurorëzuar. Ju kërkojë falje publike për fjalën nëse e keni marrë ju ashtu, por unë nuk e kam pas atë qëllim.

Kryesuesi – I nderuari Burim Krasniqi, sekretaria sapo më dëshmojë se ju ka dërguar përmes emailit rregulloret dhe udhëzimet. Poashtu edhe një herë dua të potencoj se ne të gjithë jemi të zgjedhur drejtpërsëdrejti me votat e qytetarëve, prandaj mendoj që do të hasim në mirëkuptim edhe nga ekzekutivi dhe ofendimet kundrejt kuvendarëve janë të pa tolerueshme poashtu edhe anasjelltas, veprimet të cilat i bëjnë konform ligjit janë në vetëdijen e tyre dhe përderisa është kështu nuk besoj që do të kemi ndonjë problem.

Bejtullah Deliu – Desha të ndalem tek ky diskutim sepse me të vërtetë nuk e prita nga një kryetar komune të thirrë me atë shprehje, e aq më pak kur e bënë një krahasim kur e thotë që ma mirë kishte me qenë të dilet në një subjekt tjetër se sa të bëhen këso lloje marrëveshje. Poashtu edhe tani në fjalimin e fundit që e patët i nderuari kryetar ju e thatë që shpejtë do të shkurorëzoheni, ne nuk kemi bërë kurrfarë kurorëzimi, janë marrëveshjet politike që janë bërë edhe më herët dhe asgjë nuk është risi, por nëse aludohet që do të bëhet përsëri në kohën e ardhshme, po ashtu edhe në prezantimin e borxheve apo kontratave që i kemi me vite të tërë që ju e thatë se ndoshta ne do të marrim edhe grande, gjithmonë shkoni me një ndoshta besoj se duhet të konkretizohen. Përsëri po e them që nuk ka qenë në rregull fjalia të cilën e ka shprehë, më mirë kishte me qenë të përdoret një fjalë tjetër nëse ti ke dashur të na qortosh ose akuzosh, mendoj se nuk është parimore të përdoren aso fjalë në këtë sallë të kuvendit.

Kryetari – I nderuari Bejtullah, unë jam shumë i kujdesshëm por nuk jam gjuhëtar sa ta gjejë një fjali aty për aty, ajo fjalë që e përmenda ishte ad – hoc, mua më vonë mu kujtua që është dashur ta përdori fjalinë moral politik. Është e drejtë e secilit me bë marrëveshje, poashtu është e drejtë e secilit të kalojë nga një subjekt në tjetrin, gjithashtu është e drejtë e kryetarit të komunës që të konstatojë një gjendje të cilën qytetari i komunës së Rahovecit nuk e ka dëgjuar ndonjëherë. Tani ne do të punojmë katër vite së bashku, besoj që do të kemi një bashkëpunim shumë të mirë, mendoj se secili e paguan koston e vetë dhe besoj se edhe këto marrëveshjet e juaja do të kenë një çmime, unë marrëveshjet i bëjë haptas dhe legale, kurse ju vazhdoni me këso marrëveshje dhe besomëni se sa herë që të kemi këso situata gjithmonë është më është për qeverinë.

Kryesuesi – Nuk e besoj se ekzekutivi duhet të merret me elementet e punës së kuvendit komunal, komitetet formohen nga kuvendi komunal dhe kisha bërë thirrje që mos kemi ofendime nga asnjë palë, mendoj se gjithçka do të funksionojë në rregull, marrëveshjet janë të hapura ne jemi duke përfaqësuar qytetarin dhe jemi duke tentuar që ta përfaqësojmë denjësisht, mos të harrojmë që ka marrëveshje tjera ashtu siç kanë qenë në mandatin e kaluar, por ne nuk i kemi ashtu i kemi ndryshe.

Kryetari – Nëse dikush thotë që ju ka ndalë ora ekzekutivit, atëherë mua me jepet e drejta e potë që të bëjë koment, nuk ka nevojë askush të ja tregojë askujt detyrat ne i kemi detyrat e qarta, unë jam kryetari i komunës dhe ekzekutivi është i emëruar nga unë kurse ju jeni anëtar të zgjedhur të kuvendit të komunës. Çfarëdo provokimi nga ana e kuvendit mendoni se do të kalon lehtë nga ana jonë apo anasjelltas çfarëdo provokimi nga ne për ju e di që nuk kalon lehtë. Raportet janë të qarta mos të mendon ndokush kush të ja tregojë politikat kuvendit, kryesuesi e ka për detyrë vetëm të kryesojë mbledhjen e kuvendit dhe të respektoj ligjet dhe udhëzimet, e jo të bëjë politika në kuvend. Detyra e kryesuesit është që të respektojë paanshmërinë në kuvend sepse ai është kryesuesi i të gjithëve e jo vetëm i një grupi politik.

Ilir Pallqa – Nuk e di pse i gjithë ky reagim nga kryetari, ky ka qenë vetëm një urim e jo një mallkim, uroj vetëm që kjo komunë tash e tutje të punojë sikurse kjo orë e re, ky është mendimi imë, mendimi imë poashtu është që komuna e Rahovecit tash e ca vite nga qeverisja juaj ka mbete e pa zhvilluar por tash shpresoj që do të punoni.

Sejfullah Sejfullahu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuari kryetar ju e thatë që kryesuesi është i të gjithëve, ju a nuk jeni i të gjithëve, mos na frikëso kryetar.

Kryetari – Gjithsesi Sejfullah se jam i të gjithëve, kurse i juaji më shumë, të nderuar zgjedhjet kanë përfunduar, fushatat kanë përfunduar dhe rezultati është ai 65.32% me 34.68%, a ka punuar Smajl Latifi apo jo për atë ka vendosë qytetari i Komunës së Rahovecit dhe rezultati është ai që është. Tani jemi në një etapë tjetër dhe në seancën e parë u themeluan komitetet u morën disa vendime dhe le të vazhdon puna asgjë më tepër. Kurse sa i përket orës, i nderuar komunës së Rahovecit nuk ju është ndalë ora edhe para lufte, as gjatë lufte edhe pas lufte gjatë qeverisjeve të tjera dhe qeverisjes sime.


Leonard Morina – Sa i përket marrëveshjeve tonë nuk e di pse janë duke harxhuar energji partitë e tjera ne nuk kemi ende përvojë të shkurorëzimeve. Kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, në konkursin e datës 19.01.2022, në këtë konkurs janë kërkuar 3 edukatore, në udhëzimin administrativ ceket se për edukatore janë 2 nënkategori, e parë 0-3 vjeç dhe e dyta për kopshte nga 3-6 vjeç. A ka mundësi të specifikohet në konkurs se për cilën pozitë bëhet fjala sepse kriteret e vlerësimit janë të ndryshme sa i përket përzgjedhjes së këtyre kandidatëve.

Valmir Gashi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlihem sa i përket diskutimit të orës, të nderuar ora është ndalur për arsye që nuk ka mundur të zë ritmin e punës së kryetarit.

Kryesuesi – Desha për fund dy fjalë, kuvendi komunal është rregullator i punës së ekzekutivit, zhvillimi i politikës bëhet po në këtë sallë, poashtu provokimet janë të lejuara deri në një masë si nga ekzekutivi ashtu edhe nga kuvendi, por jo të kalohet tek ofendimet. Nëse nuk ka askush diçka tjetër për të shtuar, të nderuar kolegë/e kuvendarë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, shihemi ne mbledhjen e radhës.

01 Nr. 268/22
Rahovec: 28.02.2022

Procesmbajtësi:


Agim Hoti

